



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2370/Prot.
//

Tiranë, më 28.8. 2020

URDHËR

Nr. 274, Datë 28.8.2020

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË “PSIKOLOGJI”, ME PROFILE “PSIKOLOGJI KLINIKE”, “PSIKOLOGJI SHKOLLORE” DHE “PSIKOLOGJI LIGJORE”, NË UNIVERSITETIN E NEW YORK-UT TIRANË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkolllore” dhe “Psikologji Ligjore” me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në “Psikologji” me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkolllore” dhe “Psikologji Ligjore”, në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, në Universitetin e New York-ut Tiranë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Psikologji”, me profile “Psikologji Klinike”, “Psikologji Shkolllore” dhe “Psikologji Ligjore”, në Universitetin e New York-ut Tiranë, fillon në vitin akademik 2020-2021.
3. Universiteti i New York-ut Tiranë të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, lidhur me shtimin e numrit të personelit akademik me formim të mirëfilltë psikologjik në profilin shkollor dhe ligjor për tu angazhuar në këtë program studimi; të respektohet ngarkesa dhe numri i lëndëve për personel akademik, në bazë të legjislacionit në fuqi; titullarët e lëndëve të jenë të kategorisë “Profesor”; në planin mësimor të paraqitet në

mënyrë të detajuar shpërndarja e komponentëve mësimor si leksion, seminar dhe veprimtari të tjera në bazë të krediteve përkatëse, përpara fillimit të veprimtarisë akademike të programit të studimit.

4. Universiteti i New York-ut Tiranë të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Universiteti i New York-ut Tiranë të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut Tiranë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI



Tiranë, më 29.07.2020

Relacion mbi aplikimin për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Psikologji me profile Psikologji Klinike, Psikologji Shkollore, Psikologji Ligjore” në Universitetin Privat të New York, Tiranë.

Grupi i vlerësuesve pasi u njoh me dokumentet dhe argumentet e Universitetit New York, Tiranë për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Psikologji me profile Psikologji Klinike, Psikologji Shkollore dhe Psikologji Ligjore”, vendosi vlerësimin përfundimtar pozitiv me rekomandimet si më poshtë:

- Të shtohet numri i personelit akademik me formim të mirëfilltë psikologjik në profilin shkollor dhe ligjor për tu angazhuar në këtë program studimi.
- Për të ruajtur cilësinë e programit të studimit të respektohet ngarkesa dhe numri i lëndëve për pedagog referuar udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018 për “Veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”.
- Në përputhje me Ligjin 80/15, titullarët e lëndëve të jenë të kategorisë “Profesor”.

Në planin mësimor të paraqitet në mënyrë të detajuar shpërndarja e komponentëve mësimor si leksion, seminar dhe veprimtari të tjera në bazë të krediteve përkatëse.